

JORGJI GJINARI

TIPARE TË FOLMEVE TË TOSKËRISHTES VERIORE TË NJËJTË ME TË GEGËRISHTES JUGORE

Në kumtesën tonë që u lexua në Konferencën e parë të Studimeve Albanologjike¹ ne përmendëm shkarazi si veçori të toskërishtes veriore² edhe disa tipare që paraqesin pika kontakti me gegërishten jugore. Kësaj here këtë problem duam ta bëjmë objekt të një vështrimi të veçantë për t'i parë në mënyrë më të zgjeruar dhe për t'i venë në dukje më mirë këto konkordanca.

Çështjen po e trajtojmë duke e marrë gati në mënyrë të njëanëshme, duke parë vetëm në toskërishten veriore tiparet dialektore që janë të njëjtë ose të afërt me gegërishten jugore veçanërisht e me mbarë gegërishten përgjithësisht, pra jo duke parë njëherazi edhe në gegërishten jugore tiparet e ngjashme me dialektin jugor të shqipes. Kështu kumtesa jonë zgjidh në një farë mase vetëm njërën anë të këtij problemi të ndërlikuar të dialektologjisë sonë.

Do të lemë jashtë vështrimit tonë edhe problemet që ngrejnë të folmet kalimtare, megjithëse ato kanë ndikuar gjer në një farë mase në afrimin e toskërishtes veriore me gegërishten jugore duke pasur një pozitë të ndërmjetme gjeografike. Thamë gjer në një farë mase, sepse shumë tipare të afërta ose të njëjta që vërehen sot në toskërishten veriore e në gegërishten jugore, qofshin ato konservacione ose inovacione, janë më tepër rezultat i kontakteve të drejtpërdrejta që kanë pasur gjatë kohëve të ndryshme banorët e këtyre dy zonave.

Këto konkordanca nuk janë bërë gjer më sot objekt i ndonjë stu-



1) J. Gjinari — «Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj», v. 1962, f. 15 (kumtesë e mbajtur në Konferencën e I-rë të Studimeve Albanologjike).

2) Mbi përcaktimin e toskërishtes veriore shih J. Gjinari — Po aty, f. 1.

dimi të veçantë. Vetëm O. Myderrizi³ në studimin mbi fjalorin e H. Ali Ulqinakut ilustron me disa shembuj (*harabel, iriq, sorrë, tufë, djepe-djepja*) mendimin e vet se krahina e Beratit i ka ndejtur dhe i rri mjaft afër për leksik Shqipërisë së Mesme. Por, në të njëjtën kohë, duhet theksuar se për të dy nëndialektet në fjalë dhe për të folmet kalimtare është mbledhur një material dialektor deridiku i pasur dhe janë botuar disa studime⁴. Mbi këto materiale e studime jemi mbështetur edhe ne për hartimin e kësaj kumtese.

* * *

Toskërishtja veriore dhe gegërishtja jugore shtrihen në pjesën e mesme të Shqipërisë, në tokat që përfshihen midis lumenjve Vjosë dhe Mat (shih hartën). Terreni në një pjesë të madhe nga perëndimi është ultësirë, kurse nga lindja sa vjen e lartësohet, është më shumë malor, me përjashtim të fushës së Korçës. Nëpër këtë territor të Shqipërisë, përveç Vjosës e Matit, rrjedhin edhe lumenj të tjerë, si: Osumi, Devolli, Shkumbini, Erzeni e Ishmi, shumica e të cilëve me luginat e tyre e përshkojnë vendin nga anët më lindore gjer në bregun e detit Adriatik.

Të qenët e këtyre nëndialekteve kufi me njëri tjetrin, relievi tokësor ku shtrihen ata, jo aqë i vështirë për t'u kapërcyer, luginat e lumenjve dhe rrugët e komunikacionit (nga të cilat ka pasur bile edhe në kohët e lashta, si Via Egnatia me degët që niseshin njëra nga Durrësi e tjetra nga Apollonia), kanë ndihmuar të gjitha për kontaktet e banorëve të këtyre trevave gjatë kohëve.

Ndonjë krahinë e Jugut qysh përpara pushtimit turk ka bërë pjesë në pronat feudale që e kishin qendrën e tyre në anën veriore;

3) O. Myderrizi — «Fjalori shqip-turqisht i H. Ali Ulqinakut», në «Bul. U. Sh. T. Seria Shk. Shoq.», 3, 1961, f. 121.

4) Au. Dozon — «Manuel de la langue chkip ou albanaise». Paris, 1879; G. Weigand — «Albanesischen Grammatik», Leipzig, 1913; Q. Haxhihasani — «Një vështrim mbi të folmen e krahinës së Sulovës» «Bulet. për Shk. Shoq.», 3, 1955; J. Gjinari — «E folmja e qytetit të Beratit», në «Bulet. për Shk. Shoq.» 1, 1957; «Një vështrim mbi të folmet e Oparit», në «Bulet. U.Sh.T.» 1, 1957; «E folmja e Skraparit», në «Bulet. U.Sh.T.», 1, 1958; «Të folmet e Myzeqesë», në «Bulet. U.Sh.T.», 4, 1958; «Mbi të folmen e Devollit» në «Bulet. U.Sh.T.», 4, 1960; «Vrejtje mbi të folmen e krahinës së Mallakastrës» në «Bulet. U.Sh.T.»; 3, 1963; S. Floqi — «Skicë e së folmes së Dangëllisë», në «Bulet. U.Sh.T.», 3, 1958; V. Xhaçka «Një vështrim mbi të folmen e Devollit», në «Bulet. U.Sh.T.»; 3; 1958; J. Thomaj — «E folmja e katundit Seman» në «Bulet. U.Sh.T.» 3, 1961; M. Çeliku — «Vërejtje mbi të folmen e Dumresë» «Bulet. U.Sh.T.» 3, 1963.

Prej Q. Haxhihasanit janë bërë anketa dialektologjike në Vërçë, Shpat, Polis, Domozdovë, Nahije e Beratit dhe Kolonjë (materiali ndodhet në Arkivin Institutit të Folklorit); ne vetë kemi bërë kërkime dhe kemi mbledhur material dialektor në Tepelenën toske, në Fushë të Korçës, në Pogradec, në Gorë dhe në Nahien e Beratit; prej M. Çelikut janë bërë kërkime në Krabë, Peqin, Darsi, Shpat, Grykë Zaranike, Çermenikë, Durrës, Shijak dhe prej M. Totonit kemi materiale për krahinën e Dëshnicës (materialelet e përmendura ndodhen në Arkivin e Sektorit të Gramatikës dhe të Dialektologjisë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë).

kështu në shek. XV fuqia e bujarëve Arianitas ishte rritur dhe zotërimet e tyre shtriheshin në Çermenikë, në Shpat e në Mokërr⁵.

Gjatë pushtimit turk një pjesë e madhe e qarkut të Korçës, pjesa veriore, duke filluar nga Korça, kanë qenë përfshirë në sanxhakun e Ohrit dhe në serasqerin e valiut të Manastirit⁶, pra kanë qenë të lidhura administrativisht me njësi administrative që përbëheshin në pjesën më të madhe nga krahina të Veriut të Shqipërisë.

Berati dhe Korça kanë pasur lidhje tregëtare të vazhdueshme me Durrësin. Këto dy qendra ekonomike të Toskërisë Veriore kanë qenë sipas fjalëve të G. Hahnit⁷ edhe dy shemra të forta të Elbasanit për tregtinë në krahinat e Shqipërisë së Mesme.

Elbasani ka qenë i lidhur me rrugë karvanësh me Beratin, me Korçën e me Lushnjën, bile edhe me Fierin e Vlorën⁸. Këto rrugë rriheshin nga qiraxhinj me kuaj një deri dy herë në javë.

Banorët e Toskërisë Veriore në pasojë të fqinjësisë gjeografike kanë pasur kontakte të vazhdueshme të drejtpërdrejta ose të ndërmjetme me ata të Shqipërisë së Mesme. Një rol ndërmjetës kanë luajtur pa tjetër edhe banorët e zonave që kanë të folme kalimtare, të cilët kanë pasur vazhdimisht marrëdhënie ekonomiko-politike e farefisnore edhe me zonat jugore edhe me ato veriorët. Me këto marrëdhënie shpjegohen konkordancat që duken sot në këto dy zona në gjuhë dhe në kulturën materiale e shpirtërore. Për këto të fundit mjafton të përmendim melodinë e këngëve të qytetit të Beratit, që është e afërt me ato të Shqipërisë së Mesme, të kënduarit e këngëve të Nezimit në Elbasan dhe të I. Myzyrit në Berat, këngët homofonike në qytetet e Beratit, të Fierit dhe të Lushnjës⁹ e të tjera.

* * *

Konkordancat me gegërishten jugore që shihen në toskërishten veriore janë të ndryshme për nga shtrirja territoriale, për nga sasia e rasteve ku çfaqen dhe për nga sfera e gjuhës ku vërehen.

Konkordanca që vërehen në gjithë toskërishten veriore ose në pjesën më të madhe të të folmeve të saj.

1 — Ndërsa *a* + nazal, që sot në gegërisht ndihet *â* (a hundore), ka dhënë pa përjashtim *ë* në të gjithë toskërishten, *e* + nazal, që në gegërisht ndihet *ê* (e hundore), nuk ka përfunduar në *ë* në të gjitha të folmet dhe në të gjitha rastet në toskërishten veriore.

Po të përjashtojmë të folmet e Mallakastrës dhe të Tepelenës toske, ku procesi i ndrrimit të *e*-së së ndjekur nga një nazal ka për-

5) «Historia e Shqipërisë», V. I, f. 246.

6) G. Hahn — «Albanesischen Studien» (f. 94 — përkthim).

7) G. Hahn — Po aty (f. 39 — përkthim).

8) A. Çausi — «Tregëtia në Elbasan» (dorëshkrim Vëll. I, II, gjenden në Arkivin e Sektorit të Etnografisë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë).

9) R. Sokoli — «Disa veçanti të muzikës sonë popullore» (kumtesë e mbajtur në Konf. Albanologjike në Tiranë më 1962, f. 20).

fshirë të gjitha rastet, ashtu si në Çamëri e Labëri, në të folme të tjera fenomeni është ndalur ose porsa ka filluar ose mbasi ka rrokur një pjesë të mirë të fjalëve.

Kështu në të folmet e qarkut të Korçës gjejmë sot \bar{e} ($\langle e + \text{nazal}$) rregullisht vetëm në fjalët *vënt, mënt*, kurse në të gjitha rastet e tjera zakonisht gjejmë *e* (*e* gojore): *qen, dhen, zemër, gjendje, gështenjë, ndenja, ve, le, ze* etj.

Në të folmen e Përmetit fenomeni $e + \text{nazal} > \bar{e}$ është thelluar më shumë se në anët e Beratit e të Myzeqesë, por megjithatë ka lënë pa prekur një numër fjalësh, si: *fre, pe, qen, qenq, vesht* (vresht), *femër, gjenj, emër*. Në Berat, ndryshe nga Përmeti, janë përfshirë nga fenomeni fjalët *qën, qënq, vësht* (vresht), por kanë mbatur më *e* edhe fjalë të tjera, si: *e enjte, e premte, shtrënjt, thembra* (themra), *end*. Në Myzeqe, sidomos në fshatrat që shtrihen në dy brigjet e Semanit, numrit të fjalëve me *e* që gjenden në Përmet e në Berat i shtohen edhe foljet *ve, ze, le*. Në fshatrat e Lushnjës me të folme toske afrimi në këtë rast me të folmet e gegërishtes është pothuaj në atë masë sa edhe në qarkun e Korçës.

2 — Një fenomen karakteristik që *ve* në dukje qartazi afrimin e toskërishtes veriore me gegërishten jugore është reduktimi kuantitativ i zanores \bar{e} atone. Natyrisht jo të gjitha të folmet e Toskërisë Veriore janë barabar të afërta me të folmet gege, bile ka prej tyre, siç janë ato të Përmetit,¹⁰ të cilat pothuajse nuk puqen fare në këtë rast. Të folmet e Beratit, të Myzeqesë dhe të Mallakastrës karakterizohen nga një reduktim i \bar{e} -së në pozicione kaqë të shumta, saqë mund të themi se ato janë në këtë drejtim pothuaj një me të folmet e Shqipërisë së Mesme. Në të folmet e Korçës konkordanca është e pjesëshme (me këto mund të radhisim edhe të folmen e Skraparit).

Në të folmet e Beratit, të Myzeqesë dhe të Mallakastrës \bar{e} -ja atone nuk shqiptohet sot: 1) në fund të fjalës, pavarësisht nga numri i rrokjeve që e përbëjnë fjalën dhe nga vendi që ka theksi në të: *buk, moll, les, ponic, rriponj, do shpëtonj, ercir* (errësirë), *fituan* etj., 2) pothuaj në të gjitha fjalët proklitike: *t ket* (të ketë), *t tër* (të tërë), *nj çik* (një çikë), *n shkoll* (në shkollë), *m dysh* (më dysh), 3) të shumtën e herës në një rrokje nistore të hapët: *vlla, ktu, ktej, tshër* (tërshërë), *knaqen, dgjove*, 4) rregullisht në një pozicion protonikosemion: *dimri, lakra, pjeprin, okri, Roms* (Romësi) dhe në një pozicion postonikosemion: *bakti, shqiptar, ngatron, plotson, t tërvet, u prapsua*.

Në të folmet e Korçës dhe në të folmen e Skraparit inovacioni konstatohet plotësisht vetëm në pozitë protonikosemion dhe postonikosemion. Në pozita të tjera në këto të folme procesi i reduktimit të \bar{e} -së është në fillim të veprimit të tij. Krahas rasteve të shumta me \bar{e} të ruajtur konstatohen edhe lëkundje për një numër rastesh në fjalë proklitike, në rrokje nistore të hapta dhe në rrokje fundore të fjalëve të theksuara.

3 — Kallëzorja me *i* ose *u* anaptikse (*malin, gjakun*) që në Berat dhe në Myzeqe ekziston si formë e vetme dhe përhapja e saj në një masë pak a shumë të madhe edhe në të folme të tjera të toskërisht-

10) S. Floqi — «Skicë e së folmes së Dangëllisë», në «Bulet. U.Sh.T. Seria Shk. Shoq.» Nr. 3, 1958.

tes veriore, tregojnë për një afrim që ka ekzistuar dhe që p^o bëhet gjithënjë e më tepër me të folmet gege.

4 — Një tjetër konkordancë e plotë duket edhe tek forma e s^ë ashtuquajturës rasë vendore e cila jeton sot vetëm në të folmet e toskërishtes veriore dhe në ato të gegërishtes jugore: në *gropët, nëpër lumt, mbi gurt, nën gurt, me thikët* etj.

5 — Nga përemrat pronorë si diçka të përbashkët midis gegërishtes jugore e toskërishtes veriore mund të përmendim përdorimin e shpeshtë të formave respektive: *tat, tate* dhe *tënt, tënde* të rasave të zhdrejta edhe si forma të rasës emrore: *djali tat, goca tate* (Sh. M.) dhe *djali tënt, çupa tënde* (T.V.).

6 — Në gegërishte mbaresat e vetes së parë e të dytë shumës të foljeve në bashkëtingëllore të kohës së tashme janë ndryshuar nga *ëm, ën*, në *im, in* (*lidhim, lidhin, presim, presin*), kurse në pjesën më të madhe të toskërishtes ato kanë mbetur të pandryshuara (*lidhëm, lidhën, presëm, presën*). Nga të folmet jugore ato që janë afruar në këtë rast më tepër me të folmet gege janë pikërisht ato të toskërishtes veriore që ndodhen gjeografikisht më afër Shqipërisë së Mesme: e folmja e Beratit dhe e rrethinave të tij, ajo e Myzeqesë, ajo e Korçës dhe ajo e Fushës së Korçës, deridiku edhe ajo e Skraparit.

7 — Pothuaj në të gjithë Toskërinë Veriore dhe në Shqipërinë e Mesme formohen emra abstrakt (veprimi) duke substantivuar mbiemrat e ardhur nga pjesorja e foljes: *e mbjella, e vrara, e korrura, e folura, e vjela, e kënduara, e zëna* (tosk.) dhe: *e lamja, e punumja, e lidhmja* etj. (geg.).

8 — Një togfjalësh i përbërë nga një emër i paraprirë nga parafjalët *në, mbi, nëpër, për, me* dhe nga një mbiemër i nyjshëm ose një emër i rasës gjindore në toskërishten veriore dhe në gegërishten jugore ose ndërtohet duke e vënë emrin me parafjalë në kallëzore të shquar dhe atributin me nyje të përparme *e* (*në fushën e madhe / në arën e lumit*), pra ndryshe nga ç'ndodh në të folmet skajore të shqipes ku emri është i pashquar dhe atributi me nyje të, ose ndërtohet duke e vënë emrin e parë në rasën vendore dhe atributin pa nyje (*në fushët madhe / në arët lumit*).

Konkordanca që vërehen në disa nga të folmet e toskërishtes veriore

1 — Mbarë Jugu dallohet nga Veriu për ruajtjen e oksitonisë së fjalëve me origjinë turke, por veçohen në këtë rast të folmet e qarkut të Korçës, ndër të cilat krahas fjalëve oksitone gjejmë barabar në numër edhe fjalë paroksitone: nga njëra anë *pará, xhaxhá, kafé, kafené* (kafehane), *xhezvé, bakër, air* (hair), nga ana tjetër: *báxha, kêna* (këna-ja), *básëm, shamátë, qése, qófte, shíshe, házër, daíre*.

2 — Një tjetër konkordancë fonetike me gegërishten jugore që vërehet vetëm në Myzeqe e në Berat, megjithëse në mënyrë sporadike, është fenomeni i labializimit të *i* në *y*: *sqyfter, shpyrt, (shpirt), shpyrto* (= shkrepse), *spyrto* (= alkool) në Berat dhe: *shpyrt, shpyrto, vrym-a* (vrinë), *kolybe* (kalibe), *qylym* në Myzeqe. Fenomeni i labializimit të *i*-së është karakteristik për të folmet e anës perëndimore

të Shqipërisë së Mesme (Tiranë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë), prandaj ndikimet vërehen vetëm në Myzeqe e në Berat (sidomos në Myzeqe).

3 — Fenomeni i reduktimit të *u*-së atone në disa pozita të caktuara që është më tepër karakteristik për Shqipërinë e Mesme vërehet edhe në toskërishten veriore, porse këtu e gjejmë të lokalizuar vetëm në Myzeqe, në Berat dhe në Mallakastër. Në këto të folme të toskërishtes fenomeni *u* > *ë* është i kufizuar në pozicion postonik dhe kryesisht para bashkëtingëllores *ll*: *sumbëll*, *kumbëll*, *tuvëll* (=tullë, ploçë), *kukëll*, *qerthëllonj* (qerthulloj = rrethoj). Këtu në më shumë raste në rrokje të mezit në fjalë proparoksitone *u*-ja është reduktuar krejtësisht: *sumblla*, *kumblla*, *tuvlla*, *kuklla*, *vetlla*, *petlla*, *tatlla* (tatulla), *hamblla*, *poplli*.

4 — Ashtu si në Gegëri edhe në disa të folme të Toskërisë Veriore vërehet fenomeni i shndrimit të *ë* atone në *i* në pozicion para rrokjes së theksuar. Ky fenomen konstatohet më tepër në Myzeqe, Berat, Mallakastër, në pak raste edhe në qarkun e Korçës. Zanorja *ë* ka dhënë *i* në fjalë dhe rrokje të patheksuara ku pranë saj, sidomos përpara, ndodhet një bashkëtingëllore qiellzore: *nji çoban*, *nji vlla*, *asnji dele*, *qi nga Ballshi* (që nga Ballshi) *qi mnjgjeset* (që në mëngjes), *njizet*, *njindizaj*, *gjikafshë*, *gjikundi*, *gjilpëra*, *qi kuri* (qëkuri), *qipar* (qëpar), *ginjeshtër*, *bizhdila*, në Myzeqe edhe: *qindron*, *livezhga*, *lipushka*.

5 — Ndrrimi i bashkëtingëllores grykore *h* në buzore-dhëmbore *f* që është tipar i gegërishtes dhe më i përhapur në Shqipëri të Mesme, haset edhe në krahinën e Myzeqesë, porse këtu vetëm në rastet kur ndiqet nga dhëmborja *t*: *i ngroft*, *i ftoft*, *i nxeft*, *i preft*, *i left* (i lehtë), *më vefte* (më vehte), *llaftari* (llahtar).

6 — Një konkordancë të pjesëshme tregon edhe asimilimi i grupit *mb* në *m* i cili është bërë vetëm në fund të fjalës në të folmet e Beratit, të Myzeqesë dhe të Mallakastrës: *dhëm*, *gjëm*, *shkëm*, *këm* (këmbë). Kjo gjendje ruhet edhe në format që merr fjala gjatë fleksionit ose në fjalët e prejardhura nga ajo: *shkëmi* — *shkëmit*, *u tremç*, *gjëmoem* (gjëmbohem), *komtar* etj.

7 — Në Berat, në fshatrat e tij fushorë dhe në Myzeqe pothuajse mungojnë fare raste të asimilimit të grupeve *tm*, *pm*, *tn*, *rn*, *ln*, *lln*, *thn*, *sn*.

Këtu nuk ka vepruar fenomeni i asimilimit në këta grupe, sepse, ashtu si në Shqipërinë e Mesme, ndërmjet elementëve përbërës të grupit është zanorja *ë*, e cila, ose është futur aty si anaptikse për shkak të bashkëtingëllores sonante që mbyll fjalën (*dualnë* > *dualn* > *dualën*) ose ka ardhur si rezultat i metatezës (*dualnë* > *dualën*): *vajtëm*, *përppjetëm*, *jepëm*, *mbytën*, *morën* ose *muarën*, *ngelën*, *mbollën*, *erdhën*, *ndezën*,

8 — Në të folmet e qarkut të Korçës vërehet një ndikim i gegërishtes në format e rasave gjindore, dhanore e kallzore të përemrave pronorë të vetes së parë e të dytë njejës kur prona e pronari janë njejës: (*i e*) *djalit tem*, (*i. e*) *çupës teme*, *djalin tem*, *çupën teme*.

9 — Ndërsa shumica e të folmeve të toskërishtes veriore foljet me *-n* i kanë me mbaresën *-nj* në vetën e parë njejës koha e tashme (*lanj*, *lëronj*, *lyenj*, *bluanj*), një pjesë e tyre, siç janë ato: të Pogradecit, të Gorës dhe të Fushës së Korçës i kanë këto folje me mbaresën *j*, pra ashtu si gegërishtja (*laj*, *lëroj*, *bluai*, *luej*). Në qarkun e

Korçës ky fenomen shtrihet kryesisht në anën e djathtë të rrjedhës së lumit Devoll dhe në lindje kufiri i tij arrin deri tek Gryka e Canggjonit, shtrihet pra në atë zonë që ka bërë pjesë në sanxhakun e Ohrit ose në serasqerin e valiut të Manastirit.

E vërteta është se këto folje dalin me *j* edhe në labërishte e çamërishte dhe mund të mendohet që edhe në të folmet e përmendura të qarkut të Korçës zhvillimi të jetë bërë në mënyrë të pavarur, por, duke qenë se këto të folme toske veriore nuk kanë një vazhdimësi tokësore me ato më jugoret është më e drejtë të mendohet për një ndikim të gegërishtes. Themi kështu sepse zona e Korçës, përveç vazhdimësisë tokësore me krahinat fqinjë të gegërisë ka pasur edhe marrëdhënie ekonomike e politike, marrëdhënie të cilat për më tepër kanë ekzistuar afërsisht në periudhën kur është zhvilluar ky fenomen.

10 — Të folmet e qarkut të Korçës afrohen me ato të gegërishtes edhe nga forma e foljeve pësore koha e tashme veta e dytë njejës, e cila del këtu me mbaresën (*h*) *esh* e jo me (*h*) *e* si në të gjitha të folmet e tjera toske: *lodhesh, vritesh, la(h)esh, zires*.

11 — Një lidhje të pjesëshme kanë me disa të folme gege të folmet e Beratit e të Myzeqesë (pjesërisht edhe e folmja e Mallakastërës). Kjo lidhje vërehet në fundet e mbaresës të së pakryerës veta e parë njejës (në Berat e në Myzeqe *am*, në disa të folme gege¹¹ jugore e veriperëndimore *em*): *lidhjam, flisjam, lanjam, pinjam* (tosk.) dhe: *krifshem, lajshem, hajshem* (geg.)

12 — Gegërishtja ka ndikuar tek të folmet e Pogradecit e të Gorës në format e vetës së dytë e të tretë njejës të foljeve të mënyrës lidhore koha e tashme. Ashtu si në gegëri, aty shpesh herë foljet me bashkëtingëllore ndërtohen në vetën e dytë me mbaresën *ish*: të *lidhish, të qepish, të mbjellish* (herëherë dhe foljet me zanore marrin mbaresën *jsh*: të *lajsh, të çajsh*) dhe në vetën e tretë dalin me mbaresën *i*: të *dali, të qepi, të mbjelli, të vaditi, të fleri, të zeri*.

13 — Parashtesat *sh* e *z* që u japin foljeve kuptim të kundërt ose përforcues, ashtu si në shumë të folme gege, edhe në të folmet e Beratit e të Myzeqesë ekzistojnë si të vetmet variante: *shkul, shploodhem, shkarkon, shplanj, zbath, zgjith, zbarth* etj.

14 — Një konkordancë e pjesëshme është gjithashtu edhe përdorimi në anët e Korçës i nyjes *e* tek mbiemrat me funksion predikativ: *ka gjakun e ëmbël ky / tashi i kan syt e apura / e ka vërn e ngush-të* etj.

* * *

Qëllimi ynë në këtë kumtesë nuk ishte që të vinim në dukje edhe tiparet e gegërishtes jugore të njëjta me toskërishten veriore ose me tërë toskërishten. Të këtilla ka mjaft në këtë trevë të dialektit verior, sepse kontaktet e banorëve të këtyre dy zonave kanë bërë që ndikimet të kenë qenë reciproke, por ne po mjaftohemi këtu vetëm me përmendjen e disa veçorive të gegërishtes jugore që e afrojnë këtë me toskërishten.

Grupet *kl* e *gl* kanë dhënë respektivisht *q* e *gj* (*qumësht, gjuhë*); bashkëtingëlloret qiellzore *q* e *gj* nuk afrikohen (*qafë, gjak*);

11) W. Cimochowski — «Le dialecte de Dushmani» Poznan, 1951 dhe J. Gjinar — «Dialektologjia Shqiptare», Tiranë, 1963.

bashkëtingëlloret e zëshme alternohen me të shurdhëtat kur janë në fund të fjalës (*zok, i math*); diftongjet *ae, oe* kanë dhënë e (*thë, vës*); emrat e tipit *ftu* (<*ftue*), kur shquhen, nuk e nxjerrin *n*-në e temës së fjalës: *ftu-ftoi*; po këta emra kallëzoren e shquar e formojnë nga e pashquara duke marrë drejtpërdrejt mbaresë-nyjen *n* (ë): *ftu-ftun*; përemrat pronorë të vetes së parë njejës në rasën emrore kanë format *im, ime*; forma e dytë e së pakryerës së foljeve veprare në anët e Elbasanit: *laje, laje, lante, lajin, lajit, lajin*; në anët e Elbasanit forma e së pakryerës e foljeve pësore nuk formohet nga forma e së pakryerës së veprares me pjesëzën përemërore *u*: *lahesh, laheshin, laheshit, laheshin*; ekziston forma e së ardhëshmes: *kam për t shku*; aoristi sigmatik vërehet në pjesën më të madhe të Shqipërisë së Mesme, ashtu si në shumicën e të folmeve toske, e të tjera.

Nga konkordancat e toskërishtes veriore me gegërishten jugore që dhamë këtu, disa janë tipare për gjithë nëndialektin, disa janë për një sërë krahinash që ndodhen më afër zonave veriore, kurse disa të tjera janë karakteristike vetëm për të folme të veçanta.

Vihet re se, ndërsa në anën perëndimore (Berat, Myzeqe, Mallakastër) pikat e takimit janë më të shumta në fonetikë, në anën lindore ato duken më tepër në morfologji.

Duke u mbështetur në gjeografinë e përhapjes së këtyre konkordancave, në masën e shtrirjes së tyre në këtë apo në atë vend, duke u mbështetur gjithashtu edhe në dokumentat e shkruar të gjuhës sonë, do të zgjidhen dhe do të përcaktohen këto probleme me rëndësi: cilat prej këtyre konkordancave janë ndikime në njerën apo në tjetrën anë të Shkumbinit, cilat janë fenomene që kanë ekzistuar dikur dhe që ruhen edhe sot në këta dy nëndialekte, cilat janë zhvillime të pavarura paralele dhe më në fund kronologjia e fenomeneve që formojnë pikat e takimit të këtyre dy nëndialekteve.

R é s u m é

TRAITS CONCORDANTS DES PARLERS DU TOSQUE SEPTENTRIONAL ET DU GUEGUE MERIDIONAL

La question des concordances qu'on remarque dans le tosqe septentrional et le guègue méridional est traitée dans cette communication d'une façon plus ou moins unilatérale: on fait ressortir les seuls traits des parlers du tosqe septentrional, qui sont similaires au guègue méridional en particulier et à tout le dialecte guègue en général.

Les sujets parlants de la Toskerie septentrionale, en raison de leur voisinage géographique et d'autres facteurs historiques, ont entretenu des contacts continus avec les sujets parlants de l'Albanie centrale. Un rôle intermédiaire ont joué, sans nul doute, aussi les sujets parlants des zones où existent des parlers transitoires.

Les concordances du tosqe septentrional avec le guègue méridional n'ont pas toutes la même extension géographique. Quelques unes de celles-ci sont propres à tous les parlers, d'autres à un seul groupe de parlers ou bien à un seul parler.

Les concordances sont constatées dans toutes les sphères de la langue, notamment en phonétique et morphologie. Un intérêt offre le fait que, tandis que dans la partie orientale c'est en morphologie qu'on remarque la plupart des concordances, dans la partie occidentale celles-ci sont en phonétique.

La voyelle *e*, suivie autrefois d'une consonne nasale et qui en guègue a donné *ê*, est restée *e* pour presque tous les cas dans les parlers de la partie orientale (Korçe) et les parlers tosques des agglomérations rurales de Lushnje; l'*e* n'a pas passé en *ë* en plusieurs mots aussi à Përmet, Berat, Myzeqe: *fre*, *pe*, *vent*, *gjenj*, *e preme*, *thembre* etc.

Dans la plupart des parlers du tosque septentrional, notamment ceux de la partie occidentale, a été complètement réduite la voyelle *ë* inaccentuée dans un grand nombre de positions: *buk*, *ktu*, *dimri*, *bakti*, *plotson*, *n shkoll*, *t ket*, etc.

Dans tous les parlers du tosque septentrional existe la forme du locatif, comme dans tous les parlers du guègue méridional: *në malt*, *mbi gurt*, *nëpër lumt*, *me thikët*, etc.

Dans les parlers de la zone de Korçe existent parallèlement aussi des mots oxytons et paroxytons, de ceux qui tous, en tosque, ont été transformés en paroxytons: *pará*, *xhaxhá*, *kafené*, et *básëm*, *shamátë*, *qófte*.

Dans la Myzeqé on observe dans quelques mots le phénomène du changement de l'*h* en *f*: *i ngróft*, *i ftoft*, *i left* (*i lehtë*), *më veftë* (*më vehte*).

Dans les parlers de Pogradec, Gore et du Plateau de Korçe, les verbes à *n* ont à première personne du présent singulier de l'indicatif la désinence *-j*: *laj*, *bëj*, *punoj*, etc.

Dans les parlers de la partie occidentale (Berat, Myzeqe, Mallakastër) la terminaison de l'imparfait aboutit en *-am*, et dans quelques parlers du guègue méridional et du N. -E. en *-em*: *lidhjam*, *lanjam* (en tosque), et *krifshem*, *lajshem* (en guègue).

C'est en se basant sur la géographie de la diffusion de ces concordances, dans d'autres phénomènes dialectaux de l'albanais et les données documentaires de notre langue, que sera résolue la question des influences d'un dialecte sur l'autre et la chronologie des phénomènes qui constituent les points de contact entre ces deux sous-dialectes.

